



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eglantina Gjermeni – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i kalendarit të punës së komisionit.

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermeni, Arlind Çaçani, Elona Gjebrea Hoxha, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini, Antoneta Dhima, Rudina Hajdari, Ediola Braha, Amra Barova, Almira Xhembulla, Milva Ekonomi, Enada Kapllani dhe Fatjona Dhimitri

Mungojnë:

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermeni – Mirëdita të gjithëve!

Shumë faleminderit që jeni këtu!

U bë pak kohë që nuk kemi bërë mbledhje nënkomisioni në mënyrë të posaçme, sidomos për sa i përket kalendarit. Kemi bërë aktivitete dhe takime në kuadrin e Nënkomisionit të Barazisë Gjimore.

Doja t'u uroja mirëseardhjen anëtarëve të opozitës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së pari, doja t'i uroja nënkomisionit një vit të mbarë dhe punë të mbarë!

Së dyti, më vjen keq që gjatë periudhës nëntor-dhjetor, për shkak të tërmetit, na u desh të anulonim disa aktivitete të rëndësishme të nënkomisionit. Kjo do të thotë se në këtë periudhë kohe do të kërkoj një angazhim të madh nga të gjithë kolegët, për të realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara, si dhe disa të tjera, që do t'i sugjerojmë sot si pjesë e mbledhjes që kemi për kalendarin e punës së nënkomisionit.

Doja të theksoja dhe të risillja në vëmendje që ne si nënkomision jemi krijuar pas rezolutës kundër dhunës ndaj gruas dhe, si të thuash, fokusi kryesor i punës sonë ngelet kjo rezolutë e miratuar nga parlamenti në dhjetor të 2017-s.

Ndërkohë që aktiviteti që kemi realizuar vitin e kaluar ka dhënë kontribut për zbatimin në praktikë të kësaj rezolute, mendoj se kemi jashtëzakonisht shumë për të bërë, sepse rezoluta është shumë gjithëpërfshirëse, është një program pune, si të thuash, disavjeçar, jo vetëm për parlamentin dhe nënkomisionin, por për të gjithë aktorët.

Gjithsesi, sot jemi mbledhur për kalendarin e punës së nënkomisionit.

Doja t'ju thosha dy-tri elemente, që na ngelen si detyrë edhe nga viti i kaluar, por janë pjesë edhe e zbatimit të rezolutës.

Duke qenë se kanë ndodhur një seri rastesh të dhunës ndaj grave, të dhunës në familje dhe ne si nënkomision e kemi fokus të punës këtë, si kryetare e këtij komisioni dhe si komision, sugjeroj t'u dërgojmë nga një letër (këto letra janë hartuar) të 61 kryetarëve të bashkive, duke i ndarë këto bashki në tri grupe: ato që e kanë krijuar mekanizimin e referimit koordinues të viktimave të dhunës; ato që sapo e kanë krijuar këtë mekanizëm, për të forcuar punën, si dhe ato bashki, që janë një numër më i vogël, që nuk e kanë krijuar akoma këtë mekanizëm të referimit të viktimave të dhunës, pavarësisht se është një detyrim ligjor.

Përveç letrave, mendoj se si program pune (patjetër, këtu do të doja edhe mendimin tuaj) të bëjmë disa vizita në bashkitë që e kanë krijuar mekanizmin e dhunës, duke i ndarë në

kategori: bashkitë ku po funksionon ky mekanizëm, për të dhënë edhe mesazhe vlerësuese e inkurajuese dhe bashkitë që sapo e kanë krijuar mekanizmin, duke i inkurajuar.

Mendoj se vizitat në terren do të na japin mundësi për t'i parë nga afër këta mekanizma dhe për të dhënë sugjerime konkrete. Është një përvojë që, e kemi thënë edhe vitin e kaluar, e ka bërë nënkomisioni edhe më parë, por mendoj se asnjëherë nuk është e tepërt. Përkundrazi, është shumë e rëndësishme dhe është detyrë funksionale jona.

Njoftimi tjetër është për trajnimin që kemi javës tjetër. Ju e keni marrë njoftimin. Është projekti Hygiene, që është në datën 5 shkurt. Është një projekt rajonal për nënkomisionet e të drejtave të njeriut dhe nënkomisionet e barazisë gjinore. Ata kanë një përvojë shumë të mirë dhe kanë ekspertë shumë të mirë për monitorimin e legjislacionit, mbasi ai është aprovuar nga parlamenti dhe ka hyrë në fuqi, si dhe për të parë mënyrën se si është zbatuar ose jo. Ky trajnim është realizuar në Beograd. Nga ne ka marrë pjesë kolegja Antoneta Dhima. Ne kërkuam (Vasilika si kryetare nënkomisioni dhe unë) që kjo përvojë të ndahet me të gjithë kolegët këtu, edhe me deputetët, edhe me stafin e parlamentit. Kështu që do të kërkoj angazhimin tuaj. Është një përvojë interesante, që do të na ndihmojë në punën tonë të përbashkët për monitorimin e legjislacionit, si një komponent që ka nevojë të forcohet në parlamentin tonë.

I uroj mirëseardhjen edhe nënkryetarit të nënkomisionit! I uroj shumë suksese nga ana e opozitës, zotit Arlind Çarçani!

Them se kështu jemi më të balancuar. Edhe Musai nuk është më vetëm, edhe ne kemi pak perspektivë mashkullore në nënkomision.

Falja është për ju, për sugjerime konkrete për planin e punës sonë si nënkomision, jo vetëm brenda afatit, siç e miratojmë, si kalendar nga parlamenti, 3-javor apo 1-mujor, por sugjeroj që aktivitetet, takimet apo mbledhjet që duhet të realizojmë, t'i diskutojmë së bashku për një periudhë më afatgjatë dhe t'i bëjmë në një kalendar pune, duke mirëpritur çdo koment dhe sugjerim nga ju, për të rënë dakord në terma të përgjithshme se çfarë do të realizojmë brenda këtij sesioni parlamentar.

Faleminderit!

Këto dy merake kisha. Sigurisht, kam menduar edhe disa aktivitete, por do të pres sugjerimet tuaja, që të biem dakord për një kalendar pune.

Musa Ulqini – Kjo është mbledhja e parë, ku janë dy...

Eglantina Gjermani – Kanë qenë edhe tek ajo që bëmë te Kodi për UNFPA-në, për shëndetin riprodhues, por si mbledhje zyrtare është mbledhja e parë si komision...

Arlind Çarçani – Është hera e parë që ulem në këtë komision. Nuk kam qenë te Kodi.

Eglantina Gjermeni – Te Kodi erdhe ti, tek aktiviteti me UNFPA-në, se unë të pashë.

Musa Ulqini – Si mbledhje komisioni, kjo është e para.

Eglantina Gjermeni – Si mbledhje po.

Klodiana Spahiu – Te Kodi, te Kryeministria, në katin e parë.

Eglantina Gjermeni – Ke qenë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për shëndetin riprodhues.

Arlind Çaçani – Ka qenë edhe Leskaj më duket.

Eglantina Gjermeni – Po, prandaj të mbaj mend.

Musa Ulqini – Dua t’u them kolegëve se vetëm tërmeti, një fuqi kaq e madhe, mund të pengonte kryetaren e komisionit tonë dhe komisionin tonë të mos bënim aktivitete. Pra, duhet të llogarisni që do të hani dynjanë me punët që do të bëhen këtu.

Arlind Çaçani – Do të jemi të përgatitur.

Musa Ulqini – Vetëm tërmeti...

Ediola Braha – Kam një pyetje.

Eglantina Gjermeni – Po.

Ediola Braha – Për sa i përket punës, ku ju sapo përmendët që do të organizojmë vizita në bashki të caktuara, nuk e di nëse është bërë një program, nëse është caktuar se në cilat bashki do të zhvillohen këto aktivitete...

Eglantina Gjermeni - Sigurisht, nga ministria kemi emërtimet e bashkive, që e kanë krijuar mekanizmin...

Ediola Braha – Pra, duhet ta kenë krijuar bashkitë mekanizmin dhe pastaj...

E kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni – Ju më sugjeroni dhe ne... Pra, do të jenë tri kategori: bashkitë që kanë kohë që e kanë krijuar mekanizmin, por jo gjithmonë janë shumë efikase; ato që sapo e kanë krijuar mekanizmin, për t’i inkurajuar; bashkitë e tjera që nuk e kanë krijuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë tri kategoritë. Pastaj si emërtim...

Ediola Braha - Pjesa tjetër janë bashkitë që e kanë më të nevojshme... Pra, çështja e barazisë gjinore dihet se si funksionon në disa zona të caktuara. Unë mendoj se duke bërë aktivitete të tilla mund t’i stimulojmë.

Eglantina Gjermeni – E qartë. Ne mund të japim sugjerime. E rëndësishme është të biem dakord të bëjmë vizita në terren, të bëjmë një kalendar...

Në fakt, të jem e sinqertë, është shumë e vështirë të mblidhemi ne si nënkomision, me gjithë vlerësimin që dha kolegu, sepse të gjithë janë të angazhuar të paktën në dy komisione të tjera, por sugjeroj që mbase në vizitat në terren, edhe në qoftë se nuk jemi gjithë komisioni, të paktën të ndajmë punën, që të shkojmë dhe të mos i lëmë pas dore.

Faleminderit!

Po, Klodi.

Klodiana Spahiu – Zonja kryetare, së pari doja të të falënderoja për angazhimin dhe për gjithë punën e bërë deri tani! Është e vërtetë që dy muajt e fundit ne jemi pezulluar... Jo vetëm në këtë komision, por edhe në komisione të tjera, nuk kemi qenë edhe aq aktivë.

Ashtu siç e nënvizuat edhe ju, rezoluta ka një aspekt shumë të gjerë, pra nuk ka vetëm problematikën e dhunës ndaj grave.

Unë besoj se, nisur edhe nga eksperiencia juaj dhe jona, që ishim pjesë e një aktiviteti shumë të madh ndërkombëtar për shëndetin riprodhues, duhet të fokusohemi pak edhe në këtë aspekt.

Propozoj të realizojmë, brenda mundësive, në vendin ku do të shkojmë, te bashkitë, ndoshta edhe me drejtoritë rajonale të shëndetit, objektivat që u vendosën në konferencën ndërkombëtare për shëndetin riprodhues. Besoj se kjo vlen shumë, sepse aspekti i sigurisë së gruas, që theksohet në atë rezolutë, nuk ka të bëjë vetëm me sigurinë fizike, por edhe me aspektin shëndetësor, si dhe me të gjitha aspektet e tjera, me sigurinë në punë e të tjerë.

Ne kemi bërë edhe seanca dëgjimore për sigurinë e grave dhe vajzave në punë. Besoj se ditën kur do të jemi në terren mund të përmbledhim disa tematika për të qenë sa më eficientë. Është e vërtetë që secili nga ne është në disa komisione, por megjithatë, atë ditë, kur ne do ta realizojmë... Për të thënë të drejtën, aspekti i fenomeneve që kanë ndodhur kohët e fundit, i dhunës ndaj gruas, i humbjes së jetëve, ka qenë shumë i rëndë. Këto janë ngjarje të përsëritura, por besoj se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...kjo është një problematikë që nuk e përballon dot vetëm bashkia. Kjo është një problematikë multidisiplinore, sepse aty ka shumë faktorë të tjerë. Elona i di më mirë, se është marrë shumë gjatë me këtë punë.

Mbaj mend që në Durrës, para disa vitesh, nëse të kujtohet, kemi bërë një tryezë me gratë deputete...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E drejtonte ajo që kryesonte aleancën e grave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e drejtonte Mimoza Hafizi. U mbledhëm në qendrën rezidenciale në Durrës dhe ishin të gjitha institucionet dhe aktorët që merrnin pjesë, sepse Durrësi e ka tashmë të ngritur... Tani, se ku çalon ajo, nuk e... Secila hallkë ka problematikat e veta dhe duhet bërë diçka...

Edhe si nismë, Kryeministri para një muaji përmendi ndryshime të reja ligjore, por që... Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, Klodi!

Po, Elona.

Elona Hoxha Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Më vjen mirë që mbledhemi këtu dhe flasim! U bashkohem edhe atyre që tha deputeti Musai. Pa dyshim që do të kemi një periudhë intensive me aktivitete, që, në fakt, të gjithëve do të na bëjë mirë dhe do të na duhet të angazhohemi.

Është e vërtetë ajo që thatë ju, që është e vështirë të gjenden agjendat.

Po e filloj nga fundi. Mbase mund të sakrifikojmë edhe në një nga “javët e gjelbra”. Përndryshe, do të jetë shumë e vështirë... Këto janë gjëra për të cilat besoj se do të na sillni një tabelë dhe do të duhet të kemi një dakordësi.

Kisha dy gjëra. Së pari, do të na duhet një raport vjetor për dhunën në familje. Besoj se duhet ta ketë bërë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që të kemi edhe disa shifra, që thjesht të ndahen mes nesh. Nuk ka nevojë për ndonjë mbledhje të veçantë. Mbase të gjithë duhet të punojmë pak më shumë dhe të shikojmë se çfarë mund të bëjmë.

Një sugjerim mund të jetë edhe një sinergji me aleancën. Të hënën do të bëjmë një mbledhje. Në fakt, ky ka qenë një kalendar që u shty për shkak të tërmetit. Ne kishim parashkruar që me disa gra deputete të bënim disa mbledhje në formatin që thotë Klodi, për diskutimin e dhunës dhe problematikave që ka ajo. Tani, puna është të mos krijojmë interferenca me punën e nënkomisionit, por mbase ky mund të jetë një moment ku mund të kemi edhe disa gra dhe, përveç punës në bashki, ta bëjmë përsëri punën siç e kemi bërë: aleanca me nënkomisionin.

Unë fola atëherë me Netën, Evisin dhe Klodin. I patëm ndarë edhe si formate, që mundësisht formatet të mos ishin njësoj, pra targetgrupi të ishte pak i ndryshëm dhe ramë dakord: universitetet, gratë, vunerabël e tjerë.

Mbase fasoneria është një problem tani. Nuk dua të dal nga tema, por duhet menduar diçka. Mbase e diskutojmë edhe të hënën me aleancën këtë pjesë, sepse aty futen fëmijët dhe gratë.

Përsëri fokusi i punës sonë është kryesisht nënkomisioni kundër dhunës me bazë gjinore. Kështu që, të fokusohemi këtu.

Më duket ide shumë e mirë kjo që thoni ju, që me letrat dhe ndarjet në bashki mbase mund të kemi një plan pak më real, që të jetë i shtrirë dhe të marrim disa bashki, sepse do të mbytemi me punë dhe nuk do të arrijmë... Për shembull, nga 3-4 bashki të zgjedhim një. Të kemi një konsensus mes nesh.

Edilola Braha– Një bashki në nivel qarku, them unë.

Elona Hoxha Gjebrea- Ose të mblidhen, për shembull, Fieri, Vlora e të tjerë dhe aty të diskutohet, se ndryshe...

Ndërkohë, besoj se do të ketë edhe aktivitete të tjera përveç këtyre, që të mos ngelemi vetëm te bashkitë.

Për shembull, indeksi i barazisë gjinore (në fakt, na kishin bërë ftesë të premtën, por kishim komision dhe nuk shkova dot), më duket diçka shumë e mirë...

Eglantina Gjermeni – Të martën ishte?

Elona Hoxha Gjebrea – Po, të martën.

Ndoshta me *e-mail* gocat e nënkomisionit mund të na e kalojnë, thjesht për të marrë një informacion më shumë, sepse prodhohen dokumente dhe mund t'i ndajmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni - Do ta ndërpresim dhe do të vijojmë sapo të mbarojmë votimin, ju lutem!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretare e komisionit